

**VENDIM**  
**Nr.836, datë 23.11.2011**

**PËR DHËNIEN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE**  
**“PETER MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2011-2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr.9522, datë 25.4.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit, nga të cilat 25 (njëzet e pesë) bursa studimi për nxënës të viteve përgatitore dhe 59 (pesëdhjetë e nëntë) bursa studimi për nxënës të viteve të para deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2011-2012.

2. Vlera e bursës të jetë 680 (gjashtëqind e tetëdhjetë) euro për nxënës, në vit, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e bursës do të paguhet, për çdo nxënës, në lekë.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i “Fondacionit Shkollor Austriak”, në mbështetje të kriterëve ekonomike dhe rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i “Fondacionit Shkollor Austriak”, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në Drejtorinë Arsimore Rajonale Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, e kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**